



**USAID**  
FROM THE AMERICAN PEOPLE



**Kolegji AAB**  
CILËSI. LIDERSHIP. SUKSESI!

## **THIRRJE PËR APLIKIM**

Punëtori simuluese të Ndërmjetësimit si Procedurë Alternative e Zgjidhjes së Kontesteve –  
Semestri Pranveror 2022

Fakulteti Juridik i Kolegjit AAB, në bashkëpunim me Programin e USAID-it Drejtësia Komerciale fton studentët e Fakultetit Juridik që të aplikojnë për të qenë pjesë e simulimit të rasteve të Ndërmjetësimit.

### **Rreth simulimeve të rasteve civile të Ndërmjetësimit**

Simulimi i rasteve të Ndërmjetësimit u jep studentëve mundësi që të punojnë bashkë me profesorët e Fakultetit Juridik dhe ndërmjetësuesit e licencuar, në përgatitjen e rasteve civile, potencialisht të përshtatshme për t'u ndërmjetësuar bazuar në Ligjin për Ndërmjetësim.

Studentët pjesëmarrës do të kenë mundësi që njohuritë e tyre teorike për ndërmjetësimin t'i zbatojnë në praktikë duke u bërë pjesë e rasteve të simuluar në role të ndryshme.

Studentët e përzgjedhur do të kenë mundësi fillimisht të ndjekin pjesën teorike dhe nga këtu të përgatisin raste të simuluar ku do të prezantohen para studentëve të tjerë. Klinika do të zhvillohet në hapësirat e Fakultetit Juridik të Kolegjit AAB. Studentët do të këshillohen me profesorët dhe ndërmjetësuesit gjatë gjithë përgatitjeve të rasteve simuluese. Pjesëmarrja nuk kompensohet, por mundëson praktikimin e roleve të ndryshme në një simulim praktik në një rast të ndërmjetësimit.

## **Roli dhe përgjegjësitë e studentëve**

Çdo student, në konsultim me profesorët dhe ndërmjetësuesit do të angazhohet për gatitjen e rasteve dhe roleve që do të kenë gjatë seancës simuluese të ndërmjetësimit:

- Identifikimi i rastit
- Vlerësimi mbi përshtatshmërinë e rastit për tu proceduar në Ndërmjetësim
- Përgatitja dhe argumentimi i rolit të palës paditëse dhe të paditur, rolit të avokatëve, ekspertëve të ndryshëm;
- Përgatitja e rolit të ndërmjetësuesit/ve
- Shqyrtimi i të dhënave, provave, etj.;
- Zhvillimi i seancës së ndërmjetësimi
- Hartimi i marrëveshjeve të ndërmjetësuara, etj..

## **KËRKESAT PËR STUDENTËT**

Për të qenë pjesë e simulimeve praktike, Studentët duhet:

- të jenë studentë të vitit të dytë, tretë, katërt të Fakultetit Juridik ose kandidat për Master në drejtimin Civil në Fakultetin Juridik të Kolegjit AAB
- Zotërojnë njohuri të përgjithshme mbi procedurat alternative për zgjidhjen e kontesteve
- Zotërojnë aftësi të shkrimit ligjor;
- Zotërojnë aftësi të hulumtimit ligjor
- Aftësi të mira në të folur dhe shkruar në një nga gjuhët zyrtare të Kosovës.

## **APLIKIMI**

Studentët e interesuar duhet të aplikojnë duke paraqitur një CV, Letër Motivuese dhe Transkriptin e Notave, në e-mail adresën: [trajnimet.fju@aab-edu.net](mailto:trajnimet.fju@aab-edu.net) me subjektin “Punëtorja e simulimeve të rasteve të ndërmjetësimit”, nga data **13.04.2022** deri më **17.04.2022** në ora 24:00.

Për shkak të numrit të madh të kandidatëve, vetëm kandidatët në listën e ngushtë do të kontaktohen.

### **Rreth Programit Drejtësia Komerciale**

Programi Drejtësia Komerciale është një program 5 vjeçar që financohet nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Ky Program ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Kolegjit AAB dhe Fakultetin Juridik, qëllimi i të cilit është themelimi i bashkëpunimit në fushën e drejtësisë komerciale, përkatësisht ofrimin e mundësive për studentët e përzgjedhur që të avancojnë njohuritë e tyre rreth procedurave alternative për zgjidhjen e kontesteve. Po ashtu, studentët e përzgjedhur do të kenë mundësi t'i praktikojnë vet këta mekanizma, të cilët do t'iu shërbejnë në të ardhmen që të jenë profesionistë të fushës dhe kështu ta përmirësojnë qasjen në drejtësi për qytetarët.

Përmes kësaj thirrje për aplikim, Programi mbështet studentët e Fakultetit Juridik në rritjen e mundësive për aftësim praktik dhe promovim të zgjidhjeve alternative të kontesteve.